

C.nr. 762/16

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil, gjyqtari Misin Frangu, me zyrtaren ligjore Arbelind Tahiri, në çështjen juridike të inicuar me padinë e paditësit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] të cilin me autorizim e përfaqëson [REDACTED] avokat nga [REDACTED], kundër të paditurve: [REDACTED] dhe [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna [REDACTED] të cilët e përfaqëson me autorizim [REDACTED] avokat nga [REDACTED] për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë, në seancën e mbajtur më datën 29.08.2017 ka marrë dhe publikuar këtë:

AKT GJYKIM

- në bazë të pohimit -

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna [REDACTED] dhe **VËRTETOHET** se paditësit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna [REDACTED] është pronar i ngastrave kadastrale me nr. **526-2** në sipërfaqe prej **9735 m2** në vendin e quajtur "Mukulicë" dhe ngastrën kadastrale nr. **551-2** në sipërfaqe prej **1290 m2** që gjenden në vendin e quajtur "Kopsht Oborr" Zona Kadastrale Godanc i Epërm Komuna Shtime.

II. OBLIGOHEN të paditurit: [REDACTED] dhe [REDACTED] që paditësit t'ia njohin të drejtën e pronësisë mbi këto ngastra kadastrale dhe të lejojnë regjistrimin e saj në regjistrat kadastral në emër të paditësve, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, në të kundërtën ky aktgjykim do t'i shërben paditësit si autorizim për të bërë regjistrimin e pronës në emër të tyre.

III. DETYROHET Drejtoria për Kadastër, Pronësi dhe Gjeodezi e Komunës së Shtimes, që në regjistrat Kadastral, të bëjë ndryshimin në bazë të këtij aktgjykimi, duke regjistruar këto paluajtshmëri në emrin e paditësit [REDACTED]

IV. MASA e përkohshme për sigurimin e kërkespadiisë e caktuar me aktvendimin e kësaj gjykate me datë 31.10.2016, shfuqizohet.

V. OBLIGOHEN palët ndërgjyqëse që në mënyr solidare të paguajn shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 380 €.

Arsy etimi

Paditësi përmes të autorizuarit të tij në këtë Gjykatë ka ushtruar padi më datë 26.10.2016, kundër të paditurve për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë.

Paditësi përmes të autorizuarit të tij avokatit [REDAKTUAR] në padi dhe seancat e mbajtura theksoi se mbetem në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë si dhe deklarimeve në seancat e kaluara, duke theksuar sepse marrjes së ekspertizës së datës 28.08.2017, bëjë precizimin e kërkesëpadisë së paditësit, ashtu që i propozoj gjykatës që të nxjerrë aktgjykim sipas të cilit paditësit [REDAKTUAR] do ti njihet e drejta e pronësisë në ngastrat kadastrale nr.526-0 të propozuara si ngastra 526-2, në sipërfaqe prej 9735 m², dhe të dhënat e tjera si në ekspertizë. Gjithashtu, të i njihet e drejta e pronësisë në ngastrat kadastrale me nr.551-0, për pjesën e propozuar si ngastër 551-2, në sipërfaqe prej 1290 m², në bazë të posedimit të gjatë dhe të pa penguar të tyre, blerjes të tyre dhe shfrytëzimit nga baba i i tij i ndjerë [REDAKTUAR] që e cila është pohua në tërësi edhe nga të paditurit prezent në seancë.

Shpenzimet e procedurës i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj dakordimin e palëve ndërgjyqëse e që shpenzimet për takes gjyqësore për padi dhe aktgjykim si dhe për ekspertizë palët ndërgjyqëse ti paguajnë bashkërisht, vlera e kësaj paluajtshmërie është 15.000 €, ndërsa shpenzimet e avokatëve secili veç e veç.

I padituri i parë [REDAKTUAR] ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë theksimeve në seancat e kaluara, ndërsa nuk e kundërshtoj propozimin e përfaqësuesit të paditësit që tu njihet e drejta e pronësisë në bazë të precizimit të padisë në seancën e sotme.

Përfaqësuesi i të paditurit të dytë [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] avokat nga [REDAKTUAR] ka deklaruar, pasi pranova plotësimin e ekspertizës së datës 25.08.2017, i cili plotësim si në skicën e paraqitur ashtu edhe në pjesën tekstuale është rezultat i marrëveshjes së arritur me

në vendin e quajtur "Mukulicë", Zona Kadastrale Godanc i Epërm Komuna Shtime, e cila nga ana lindore me gjatësi 105.12 m², kufizohet me pronarin [REDACTED] dhe me gjatësi prej 17.54 m, bashkëpronar [REDACTED] dhe [REDACTED], ndërsa në anën perëndimore me gjatësi 96.37 m, kufizohet me posedues [REDACTED] nga ana veriore me gjatësi 100 m, kufizohet me rrugë publike e cila identifikohet me nr.523-0, në anën jugore me gjatësi 85,24, kufizohet me ngastrën me nr.736-0, e cila evidentohet në emër të Pasurisë Shoqërore e Ujrave. Dhe ngastrën kadastrale nr. 551-2 në sipërfaqe prej 1290 m² që gjenden në vendin e quajtur "Kopsht Oborr" Zona Kadastrale Godanc i Epërm Komuna Shtime, e cila nga ana lindore me gjatësi prej 65.76 m, kufizohet me bashkëpronarët [REDACTED] dhe [REDACTED], ku është e kufizuar me muri, nga ana perëndimore me gjatësi prej 40.23 m, kufizohet me poseduesin faktik [REDACTED] [REDACTED]-ku është e kufizuar me muri, nga ana veriore me gjatësi prej 36.48 m, kufizohet me ngastrën.nr.736-0 e cila evidentohet në emër të Pasuri Shoqërore e Ujërave –është e kufizuar me taraba prej druri, nga ana jugore me gjatësi prej 27.16 m, kufizohet me rrugën publike e cila identifikohet me nr.554-0 ku është e kufizuar me objektin që është i ndërtuar (P).

Gjykata ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve si të pohuar duke qenë se në mes palëve ndërgjyqjese nuk ishin kontestuese faktet vendimtare të çështjes dhe se i paditur i parë dhe respektivisht përfaqësuesi i të paditurit të dytë ka pranuar kërkesëpadinë duke i pranuar faktet dhe provat e propozuara si të vërteta dhe në anën tjetër, gjykata nga shqyrtimi i gjithmbarshëm i çështjes nuk ka gjetur ndonjë rrethanë, për të cilën duhet kujdesur kryesisht e cila do të pengonte aprovimin e kërkesëpadisë dhe rrethana tjera që t'i vënte në kundërshtim faktet dhe provat e çështjes me pohimin e kërkesëpadisë nga ana e përfaqësuesit të përkohshëm të paditurit.

Andaj në kuptim të nenit 148 të LPK-së, ka nxjerr aktgjykim në bazë të pohimit, *(në qoftë se i padituri deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (aktgjykimi në bazë të pohimit).*

Gjykata ka obliguar paditësin dhe të paditurit që në mënyrë solidare të paguaj shpenzimet e procedurës dhe atë taksën për padi në shume prej 80 €, në emër të ekspertizës 300 € në bazë të nenit 451.2 të LPK-së.

ndërmjetësimin e personave të tretë me datë 26.05.2017, dhe plotësuar me datë 10.06.2017, për të cilën i padituri i dytë paditësit i ka paguar shumën prej 5000 €, dhe janë marrë vesh që shpenzimet gjyqësore për taksa dhe ekspertizë të paguhen në pjesë të barabarta, andaj precizimi i paraqitur nga pala paditëse në seancën e sotme, nuk është kontestuese dhe është rezultat i marrëveshjes së cituar dhe për paditësin e dytë kërkesëpadia e paditësit është e pranuar përkatësisht pohohet në tërësi në të cilin ai bëhet pronar siç u precizua në shqyrtim.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes së fakteve të çështjes, për aq sa palët ndërgjyqëse përmbushin detyrimin e tyre për t'i parashtruar ato, në kuptim të nenit 7.1 dhe 8 të LPK-së, Gjykata ka administruar një mori provash: Kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë të datës 08.03.2012 mes blerësit [REDAKTUAR] dhe shitësit [REDAKTUAR] Procesverbali i vendshikimit të datë 09.03.2017, Ekspertiza e punuar nga eksperti [REDAKTUAR] të datës 09.03.2017, Plotësim ekspertiza e punuar nga eksperti [REDAKTUAR] të datës 03.04.2017, Plotësim ekspertiza e datës 25.08.2017, Marrëveshja e datës 26.05.2017 dhe plotësimi i marrëveshjes i datës 10.06.2017.

Eksperti i gjeodezisë, [REDAKTUAR], pas daljes dhe këqyrjes në vend, ka përpiluar plotësim ekspertizën me shkrim të datës 25.08.2017, në të cilin ka deklaruar se: ngastra kadastrale me nr.256-0, në sipërfaqe prej 9735 m² gjendet në vendin e quajtur "Mukolicë" Zona Kadastrale Godanc i Epërm Komuna Shtime, e ndarë në dy parcela: nr.256-1 dhe parcela nr.256-2 e cila nga ana lindore me gjatësi prej 105.12 m, kufizohet me pronarin [REDAKTUAR] dhe me gjatësi prej 17.54 m me bashkëpronarët [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] ku është e kufizuar me gardhë. Nga ana perëndimore me gjatësi prej 96,37 m, kufizohet me poseduesin faktik [REDAKTUAR] e kufizuar me tel. Nga ana veriore me gjatësi prej 100 m, kufizohet me rrugën publike e cila identifkohet me nr.523-0 ku është e kufizuar është e kufizuar me tel. Nga ana jugore me gjatësi 85,24 m kufizohet me ngastrën 736-0 e cila evidentohet në emër të Pasurisë Shoqërore e Ujrave dhe pjesët e ngastrës nr.526-0 me sipërfaqe prej 322 m² dhe sipërfaqe prej 155 m².Ngastrën kadastrale me nr.551-2 e cila ka sipërfaqe prej 1290 m² me kultur Arë-4 që e ka në posedim faktik [REDAKTUAR]

Gjykata pas deklarimit të palëve ndërgjyqëse dhe deklarimit të ekspertit ka konstatuar se paditës [REDAKTUAR] është pronar i ngastrës kadastrale me nr. 526-2, në sipërfaqe prej 9735 m²

Mbi bazën e parashtrimeve të mësipërme është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ

C.nr. 762/16, me datën 29.08.2017




Gjyqtari,
Misin Frangu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JË PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROŠEVAC



06 10 2017